



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar sipas raportit të paraqitur nga një kërkues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 82-të të mbajtur më 14 shkurt 2023, miratoi,

VENDIM

Denoncimi me numër 12-3754/1 të datës 02.11.2020. HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për faktin se në denoncimin e dorëzuar nuk ka pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare dhe pretendimet e paraqitura nuk paraqesin bazë për fillimin e ndonjë procedure për të cilën KSHPK-ja është kompetente sipas ligjit.

Lënda me numër 12-3754/1 të datës 02.11.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e Komisionit Shtetërorë në afat prej 5 (pes) ditëve nga miratimi.

Arsyetim

Më datë 11.02.2020, një parashtues i panjohur ka dorëzuar denoncim të regjistruar me numër 12-3754/1, datë 11.02.2020, me pretendime se gjykata ka favorizuar ekspertë që nuk posedojnë licencë. Në denoncim janë paraqitur mendime personale dhe është ndarë praktika personale që gjatë këqyrjes në vend gjykatat në vend të ekspertëve dërgojnë persona pa licencë eksperti, të cilët paraqiten si ekspertë gjatë procesit gjyqësor. Kjo praktikë ishte veçanërisht e pranishme në mosmarrëveshjet për tokën. Evidentohen disa shoqata për ekspertizë gjeodezike, të cilat dyshohet se janë favorizuar nga gjykata dhe për të cilat gjithashtu tolerohet që ekspertiza e tyre të përgatitet dhe/ose të nënshkruhet nga persona që nuk janë të regjistruar në Regjistrin e Ekspertëve pranë Ministrisë së drejtësisë. Në denoncim propozohet të saktësohet në rregulloren ligjore përzgjedhja e ekspertit nga gjykata, duke zbatuar rregullin e përzgjedhjes së rastësishme nga Regjistri i ekspertëve me praninë e të dyja palëve, pra të prokurorëve të tyre dhe denoncimi është dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës Themelore Civile Shkup. Pikëpamjeve të shprehura i janë bashkangjitur dëshmi.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja konstaton se denoncimi i paraqitur përmban situata të përgjithshme, pa specifikuar persona dhe aktivitete të veçanta dhe nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushtetit publik dhe detyrat zyrtare, dhe konstatoi se pretendimet e paraqitura në kërkesë nuk ofrojnë bazë për fillimin e ndonjë procedure për të cilën KSHPK-ja është kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Nga aty, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent për rastin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Nënkryetar,
Katica Nikolovska

përgatiti: J.C
Miratoi: K.N., Anëtar i KSHPK-së

